



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 67 Prot.

Tiranë, më 14.07.2020

VENDIM

Nr. 22, Datë 14.07.2020

PËR

LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT NR.9, DATË 08.07.2020 TË KOMISIONIT
ZGJEDHOR TË FAKULTETIT TË MJEKËSISË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË

Në bazë të Rregullores së Zgjedhjeve, miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Komisioni Institucional Zgjedhor, pasi shqyrtoi ankimimin e Z. Arben Lloja me nr. Prot. 63, datë 13.07.2020, mbi vendimin Nr. 9, datë 08.07.2020 të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Mjekësisë për “Mosmiratimin e Kandidaturës së Prof. As Arben Lloja për drejtues të njësive bazë të Anatomisë-Patologjike dhe Mjekësisë Ligjore”, dokumentacionin e dorëzuar nga ankimuesi, dhe KZ e Fakultetit të Mjekësisë, në mbledhjen e datës 14.07.2020,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 9, datë 08.07.2020 të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Mjekësisë për “Mosmiratimin e Kandidaturës së Prof. As Arben Lloja për drejtues të njësive bazë të Anatomisë-Patologjike dhe Mjekësisë Ligjore” me argumentimin bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në ambientet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së dhe një kopje i vihet në dispozicion z. Arben Lloja.

